



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	07.03.2016
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Shkurt 01.02.2016-29.02.2016

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor , dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime - kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrimi i xhirollogarisë.

Në të gjitha shkollat e Komunës sonë ka filluar të mbahet mësimi shtesë - plotësues për nxënësit e riatdhesuar.

Mbajtja e trajnimit A-Egra (vlerësimi i leximit të nxënësit në klasat e hershme) për disa mësimdhënës të shkollave fillore, i cili është ofruar në mbi 100 shkolla fillore të Kosovës dhe është konsideruar nga mësimdhënësit e trajnuar si një ndër kurset më të nevojshme për mësimdhënësit e ciklit të ulët.

Përgatitja teknike-administrative për Olimpiadën Matematikore që do të mbahet në nivel komunal më datë 03.03.2016 për nxënësit e klasës së IX (nëntë), X (dhjetë), XI (njëmbëdhjetë) dhe XII (dymbëdhjetë).

Mbledhje me drejtorët e të gjitha shkollave në të cilën mbledhje është diskutuar rreth përgatitjeve për nderë të festës së 7 Marsit ditës së Mësuesit, ndryshimet në legjislacionin e ri si dhe çështje të ndryshme me rëndësi në procesin edukativo-arsimor.

Takim me përfaqësuesit e OMPAK-it për nxënësit me nevoja të veqanta, në të cilin takim përfaqësuesit e kësaj shoqate kanë kërkuar nga ne evidentimin e nxënësve me nevoja të veqanta, bashkëpunim më të mirë në mes tyre, neve si DKA dhe drejtorëve të të gjitha shkollave në mënyrë që t'u ofrojmë ndihmë dhe përkrahje të vazhdueshme këtyre nxënësve.

Takim me përfaqësuesin e OSBE-së në të cilin takim është diskutuar rreth problemit të braktisjes së nxënësve në shkolla.

Pjesëmarrja në tryezën për Arsimin Gjithëpërfshirës e organizuar nga MASHT-i, në të cilin tryez është diskutuar për problemet me të cilat ballafaqohen nxënësit me nevoja të veqanta dhe cilat janë mundësitë që ofrojnë shkollat për këta nxënës.

Kërkesë drejtoratit të shërbimeve publike për:

- Paramasë dhe paralogari për ndërrimin e dritareve në Shfmu "Ibrahim Krasniqi" në Smallushë,
- Paramasë dhe paralogari për riparimin e rrethojës në Shfmu "Zenel Hajdini" në Gadime,
- Paramasë dhe paralogari për ndërrimin e dyshemes në Shfmu "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe dhe Shfmu "Migjeni" në Rufe i Ri,
- Paramasë dhe paralogari për aneks (objekte ndihmëse) në Shfmu "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe.

Kërkesë drejtoratit të prokurimit për:

- Zhvillimin e procedurave të procedurave të prokurimit për furnizimin e Ekonomisë Bujqësore me plehra të ndryshme minerale,
- Zhvillimin e procedurave të prokurimit për furnizimin e Ekonomisë Bujqësore me fara të ndryshme për bimë dhe perime të ndryshme,
- Riparimin emergjent të kulmit në Dobrajë,
- Zhvillimin e procedurave të prokurimit për ndërtimin e rrethojës në Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve.

Kërkesë drejtoratit për gjeodezi dhe kadastër për përcaktimin e pikave kadastrale në Shfmu "Emin Duraku" në Banullë, p.n.f në Glllogovc.

Kërkesë MASHT-it për furnizim me paisje sportive për sallën sportive të objektit të ri Gjimnazit "Ulpiana" në Lipjan.

Zotimi i mjeteve në kategorinë - Mallra, komunal dhe kapitale.

Kalkulimi i pagave në bazë të padive gjyqësore.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.